



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për : Bashkimin e operatorëve ekonomik

“ Ed Konstruksion ” sh.p.k

Me adresë :

Njësia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndërtesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 6

TIRANË

+

“ Arkonstudio ” sh.p.k

Me adresë

Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Frosina Plaku, Pallati nr.21, Shkalla A, Apartamenti nr.5,
Kati III – të

TIRANË

Procedura e prokurimit : **Procedurë e Hapur – Punë Publike** .

Numri i referencës së procedurës : **Nr REF – 19684-04-25-2019** .

Përshkrim i shkurtër i kontratës , objekti : **“ Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori ”**, me fond limit me vlerë : **64 093 023** (gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzetë e tre) **lekë pa tvsh**.

Afati për ekzekutimin e kontratës : do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së Kontratës .

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit me vlerat përkatëse të ofruar si më poshtë :

1. “ **4 A- M** ” shpk me Nr NIPT-i **K 92005016 L** me ofertë ekonomike : **63 778 314** (gjashtëdhjetë e tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e katërbëdhjetë) **lekë pa tvsh .**
2. “ **Alba Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **J 61812013 R** me ofertë ekonomike : **62 619 368** (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa tvsh .**
3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ **B - 93** ” shpk me Nr NIPT-i **J 62903508 R** , dhe “ **BE – IS** ” shpk me Nr NIPT-i **K 71412003 A** me ofertë ekonomike : **57 642 110** (pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e dhjetë) **lekë pa tvsh .**
4. “ **Deutschcolor** ” shpk me Nr NIPT-i **L 21326504 J** , pa me ofertë ekonomike .
5. Bashkimi i operatorë ekonomik “ **Ed Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 61625001 I** , dhe “ **Arkonstudio** ” shpk me Nr NIPT-i **L 42019004 I** me ofertë ekonomike : **62 150 364** (gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) **lekë pa tvsh .**
6. “ **Elda VI** ” shpk me Nr NIPT-i **K 67106202 W** , pa ofertë ekonomike .
7. “ **Flondi Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **J 74818819 M** me ofertë ekonomike : **63 024 787** (gjashtëdhjetë e tre milion e njëzetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) **lekë pa tvsh .**
8. “ **Kola Invest Invest** ” shpk me Nr NIPT-i **K 93103401 G** me ofertë ekonomike : **57 496 738** (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) **lekë pa tvsh .**
9. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ **Leon Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 71820009 I** , dhe “ **Meteo** ” shpk me Nr NIPT-i **L 26310801 C** me ofertë ekonomike : **55 116 168.9** (pesëdhjetë e pesë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë 9) **lekë pa tvsh .**
10. “ **Shëndelli** ” shpk me Nr NIPT-i **K 07924803 N** , pa ofertë ekonomike .
11. “ **Totila** ” shpk me Nr NIPT-i **K 13001010 G** me ofertë ekonomike : **48 321 652** (dyzetë e tetë milion e treqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë dy) **lekë pa tvsh .**

Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :

1. **4 A - M ” shpk** shpk me Nr NIPT-i **K 92005016 L** , skualifikohet sepse rezulton me dokumenta te parregullta , ky operator ka paraqitur vetem QKB, vertetimin e OSHEE , vertetim për xhiron mesatare për tre vitet e fundit , Bilancin e vitit 2016, 2017,2018 gjithashtu dhe vërtetimin për taksat vendore , liçencen e shoqeris.Çertifikatat ISO dhe liçensën III.2.A për ndikimin në mjedis . Nuk ka paraqitur dokumenta të tjera.

2. **Alba Konstruksion ”** shpk me Nr NIPT-i **J 61812013 R** me ofertë ekonomike :

62 619 368 (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa tvsh** , skualifikohet sepse rezulton me dokumenta të parregullta.Nuk ka paraqitur dokumenta për punë të ngjashme , nuk ploteson puntoret dhe stafin teknik të paisur me dëshmi të sigurimit teknik dhe çertifikata trajnimi për 1(një) elektrikist(kat IV-V), dy murator (kat 1) , 2 (dy) suvaxhi (kat 1) , 2 (dy) punonjës specialis për punime durale (kat, I) 4(kater) specialist për punime në lartësi(kat ,1). Gjithashtu nuk ka paraqitur list pagesat për periudhen Prill 2018-Prill 2019, nuk paraqitur dokumenta vertetues per makinerit motobetoniere , kamionçinë 1-3 tonë, pomp suvatimi , paisje për hekur thyes , nyje inerte e paisur me leje mjedisore, autorizim prodhuesi /distributor dhe çertifikat ISO 9001:2015 për materiale elektrike dhe hidraulike.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“ B - 93 ”** shpk me Nr NIPT-i **J 62903508 R** , dhe **“ BE – IS ” shpk** me Nr NIPT-i **K 71412003 A** me ofertë ekonomike **:57 642 110** (pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e dhjetë) **lekë pa tvsh** . Skualifikohet sepse rezulton me dokumenta te parregullta .Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik **“ B - 93 ”** shpk është bashkim operatoresh me **“BE – IS ” gjë të cilën** nuk e kanë deklaruar ne sitem :Shoqëria **“ B - 93 ”** nuk ploteson kriteret e pergjithëshme të kualifikimit si psh. Shtojcen 7. Shoqëria **“B-93”** nuk ka deklaruar personin në cilësin e operatori të organit të administrimit ... nuk janë dënuar me vendim të formë së prer sipas nenit 45/1 . Nga verifikimi i ekstraktit të subjektit **“ B - 93 ”** rezulton se administrator është Shpetim Liçaj dhe ortak Dashnor Liçaj. Operatori ekonomik ka deklaruar vetëm ortakun e kësaj shoqërie por jo administratorin e vetë Z. Shpetim Liçaj. Gjithashu mungojnë mjete autobot uji , pasi mjete me targa AA831LV ,Automjeti i operatorit **“ B - 93 ”** i ka mbaruar çertifikata e

transportit që në datë 16.10.2018, kurse mjetet me targa AA176 NH dhe AA 095VO të Shoqeris “BE-IS” SH.P.K janë autobote për transportime karburanti (lëndë të rrezikshme) nuk janë bote uji. Gjithashtu nuk plotëson kushtin për mjetin vinç 0.5-1 ton , nuk ka paraqitur dokumenta. Operatori nuk plotëson pikën 17 të kriterëve të kualifikimit pasi në marrveshjen e bashkimit të operatorëve , ndarja e punimeve të operatorit “BE-IS” ka marrë punime elektrike , ngrohje dhe hidraulike , por ka paraqitur një kontratë përfundimtare hidraulike e kompanive “VIBTIS” e cila përkon me çertifikaten ISO .Kjo shoqëri në bazë të ndarjes ka detyrë të paraqes dhe autorizim produkti material elektrik pasi në zëra punoimesh janë marrë për sipër nga kjo shoqëri , nuk ka paraqitur një të tillë.Autorizimi i shoqërisë “B-93” me Shoqërin Sali elektrik nuk ka vlerë pasi kjo shoqëri ka marrë përsipër punime muratore, betoni etj..

4. **Deutschcolor ” shpk** me Nr NIPT-i **L 21326504 J** , pa me ofertë ekonomike dhe dokumentacion për këtë arsye skualifikohet.
5. **“ Elda VI ” shpk** me Nr NIPT-i **K 67106202 W** , pa ofertë ekonomike dhe pa dokumentacion për këtë arsye skualifikohet.
6. **“ Flondi Konstruksion ” shpk** me Nr NIPT-i **J 74818819 M** me ofertë ekonomike **63 024 787** (gjashtëdhjetë e tre milion e njëzetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, rezulton me dokumentacion të parregullt : Nuk ka paraqitur dokumenta për makinerit , dokumenta për mjete dhe pajisje mbrojtëse me liçensen e shoqëris gjithashtu i mungojn kategorit NP-12 A , NS-14A , NS-18, NS-19.Nuk ka paraqitur inxhinjerët e kërkuar nuk ka paraqitur puntor dhe staf teknik të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe çertifikat të trajnimit të leshuar nga shoqërit të akredituara nga **DPA** e tj, për mungesat e lartë përmendura operatori ekonomik skualifikohet.
7. **“ Kola Invest Invest ” shpk** me Nr NIPT-i **K 93103401 G** me ofertë ekonomike **57 496 738** (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh, rezulton me dokumentacion të parregullt . Ku nuk ka paraqitur dokumenta për mjetet 3.5-5 ton , pasi nuk disponon mjete kamioni 3.5-5 ton , pasi mjetet e paraqitura **TR 9575S dhe AA761CE** nuk plotesojne këte tonazh prej 3.5-5 ton këto mjete janë më pake se kriteri i kërkuar.Gjithashtu nuk ka paraqitur dokumenta për mjete **1-3 ton** , pasi mjet **TR5941K** i ka mbaruar sigurimet me datë 13.07.2018,

mungojne 2(dy)automekanista në përputhje me urdherin 44 ,date 04.02.2004. Operatori ekonomik për mungesat e lart permendura skualifikohet.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ **Leon Konstruksion** ” shpk me Nr NIPT-i **K 71820009 I**, dhe “ **Meteo** ” shpk me Nr NIPT-i **L 26310801 C** me ofertë ekonomike : **55 116 168.9** (pesëdhjetë e pesë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë 9) lekë pa tvsh , nga kontrolli i dokumentacionit operatori ekonomik nuk e ka deklaruar në sistem që është bashkim operatresh me “Meteo” gjithashtu nuk ka paraqitur dokumenta per mjetet kamionçin 2(dy) copë, ka vetem një të tillë, pasi mjete me **targa AA152VK është 346 ton** në kundeshtim me vendimin e **KPP-se nr.840/2018**. Operatori gjithashtu nuk ka paraqitur dokumenta për mjetin autobetoniere 2(dy) copë dhe autopomp , pasi çertifikata e transportit kanë përfunduar më datë 26.04.2019 , për këtë arsye janë jashtë afatit .Vinçi kulle nuk plotësohet. Nuk ka paraqitur liçens për ndikimin në mjedis me kod III .2.A(1+2).Operatori “**Meteo**” nuk ka paraqitur asnjë mjet , pasi në kontratën e bashkpunimit ka marrë zëra punime gërmime dhe sistemime të jashtme .Arkiteti i paraqitur nuk është në listepagesat në periudhen kohore të kërkuar. Per keto arsye të lartëpermendura operatori skualifikohet.
9. “**Shëndelli** ” shpk me Nr NIPT-i **K 07924803 N** , pa ofertë ekonomike dhe pa dokumentacion për këtë arsye skualifikohet .
10. “ **Totila** ” shpk me Nr NIPT-i **K 13001010 G** me ofertë ekonomike **48 321 652** (dyzetë e tetë milion e treqind e njëzetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh ky operator ekonomik rezulton me dokumentacion të parregullta, ku nuk ka paraqitur asnjë dokument për makinerit e kerkuara, dokumenta për paisje dhe mjete mbrojtese , gjithashtu nuk ka paraqitur dokumenta për inxhinjer elektrik dh arkitekt, nuk ka paraqitu puntor dhe staf teknik të paisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe çertifikata të trajnimit të lëshuar nga shoqerit të akreditua nga **DPA** për mungesat e lartë për mendura skualifikohet .

* * *

OPERATORET E KUALIFIKUAR

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomik “ **Ed Konstruksion** ” shpk & “ **Arkonstudio** ” shpk me ofertë ekonomike **62 150 364** (

gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) , është identifikuar si oferta e suksesshme .

Ankesa , JO .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **BASHKISË KUÇOVË**, bashkë me gjithë dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në tender, original ose kopje e njehsuar me origjinalin para Noterit Publik , siç parashikohet në dokumentat e tenderit.

Në zbatim të nenit 21, pika 3 paragrafi i parë, të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014, jo me vonë se 60 dite nga publikimi i këtij njoftimi, Autoriteti Kontraktor, njofton Operatorin Ekonomik të shpallur fitues. Po në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar neni 21 paragrafi i dytë, Operatori Ekonomik, duhet ti përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor brënda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit .

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do te procedohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik ”, i ndryshuar .

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19 / 06 / 2019



TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Selfo KAPLLANI